



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/285
Datë: 26.01.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 janar 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Këshilli Organizativ për shënimin e tetëmbëdhjetë (18) vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, në këtë përbërje:
 - 1.1. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryesues;
 - 1.2. Përfaqësuesi i Ministrisë së Mbrojtjes, anëtar;
 - 1.3. Përfaqësuesi i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, anëtar;
 - 1.4. Përfaqësuesi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, anëtar;
 - 1.5. Përfaqësuesi i Zyrës së Kryeministrit, anëtar dhe
 - 1.6. Përfaqësuesi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar.
2. Ftohen që të dërgojnë nga një përfaqësues në Këshill:
 - 2.1. Zyra e Presidentes, anëtar;
 - 2.2. Kuvendi i Republikës së Kosovës, anëtar;
 - 2.3. Komuna e Prishtinës, anëtar;
 - 2.4. Organizatat e dala nga Lufta e UÇK-së, anëtar;
 - 2.5. Asociacioni i Komunave të Kosovës, anëtar; dhe
 - 2.6. Përfaqësues të OJQ-ve.
3. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Këshilli Organizativ për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/285

Datë: 26.01.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 30 të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 janar 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Autorizohet pagesa në shumën prej 154,000€ (njëqind e pesëdhjetekatër mijë euro) për Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për rritjen e kuotës së kapitalit të Qeverisë së Republikës së Kosovës në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.
2. Mjetet sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga bilanci bankar i Llogarisë së Vetme të Thesarit dhe autorizohet Thesari i Kosovës që të procedojë me transferimin e mjeteve në shumën përkatëse te Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë